



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1078/24 Datë: 30/05/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/I-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funksonimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 122-të, mbajtur me datë 22.04.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

V E N D I M

- I. Riakreditohet Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë në nivel institucional, për periudhën tre (3) vjeçare 1 tetor 2024 - 30 shtator 2027.
- II. Obligohet Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë që deri më datë 15.11.2024 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertet ndërkombëtar të akreditimit.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij,

A R S Y E T I M

Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë ka parashtruar kërkesë për riakreditim institucional me Nr.prot. 1516/23, datë 31.10.2023 në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (në tekstin e mëtejme AKA).

Me qëllim të vlerësimit në nivel institucional AKA me datë 07.02.2024 ka organizuar vizitën me ekipin e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit me përbërje: Milan Pol, Magdalena Platis dhe Lali Giorgitze.

Bazuar në nenin 17 të UA. Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (ekspertëve ndërkombëtarë) ka hartuar raportin e vlerësimit dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka konstatuar se nga njëmbëdhjetë (11) fushat e standardeve të akreditimit, Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë është vlerësuar se përmbushë: Plotësisht pesë (5), Substancialisht pesë (5) dhe Pjesërisht një (1) fushë të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 123-të, të mbajtur më datë 20.05.2024 ka shqyrtuar kërkesën/aplikacionin e Universitetit “Fehmi Agani” në Gjakovë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitës si dhe rekomandimin përfundimtar të dhënë në raportin final të vlerësimit nga ekspertët e cekur me sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala mund të parashtrij ankesë sipas Ligjit Nr.05/L-031 mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative në organin që ka nxjerrë këtë vendim, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,



Prof. Assoc. Dr. Hasnija Ilazi
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë